



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 93-të, të mbajtur më 29.09.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-4092/1 të datës 25.08.2023 , kundër personave përgjegjës- -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse ka konsideruar se autoriteti tjetër është kompetent për të vepruar.

Lënda me numër 12-4092/1 të datës 25.08.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një kërkues i njohur, me datë 25.08.2023, kundër personave përgjegjës në Qendrën për Punë Sociale – ----- është bërë denoncim dhe është konstatuar lënda me numër 12-4092/1, datë 25.08.2023.

Në denoncim, si dhe në shtesat ndaj denoncimit, parashtrues, i cili jetonte dhe punonte në Holandë, thekson se ishte prind i një fëmije të mitur jashtëmartesor (vajzë) që jetonte me nënën e saj në ----- dhe ndaj të cilit edhe përkundër faktit se i ka përbushur rregullisht obligimet mujore për pagesën e mjeteve ushqimore, megjithatë Qendra për Punë Sociale nuk ka organizuar takime me vajzën e tij nga ----- . Kërkuesi iu drejtua disa herë Qendrës për Punë Sociale në ----- si dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, duke shprehur problemin dhe revoltën e tij nga institucioni. Ai po ashtu ka kërkuar nga Qendra për Punë Sociale që t'i lejojë takimet në vendin e tij ku ka jetuar në Holandë dhe për të cilën kërkesë gjithashtu nuk ka marrë përgjigje pozitive.

Pas shqyrtimit tē pretendimeve nē fjalē, KSHPK-ja ka konstatuar se nē rastin bēhet fjalē pēr pretendime qē nuk janē objekt i veprimit tē saj kompetent, por kanē tē bējnē me veprimtari nē kompetencē tē njē autoriteti tjetēr, pas sē cilēs ka konstatuar se nuk ka elemente pēr veprim pēr rastin nē fjalē.

Nga sa mē sipēr, KSHPK-ja vendosi si nē dispozitiv tē kētij vendimi.

Dorēzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Pērgatiti: K.Z

Miratoi: K.N anētar i KSHPK-sē

**KOMISIONI SHTETЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Kryetar,
Biljana Ivanovska
